



URDHËR

Nr. 13, datë 7.2.2023

PËR

**NGRITJEN E KOMITETIT NDËRMINISTROR DHE EKIPIT
KOMBËTAR TË STRATEGJISË SË SPECIALIZIMIT INTELIGJENT
(S3) PËR ORGANIZIMIN DHE NDJEKJEN E VEPRIMTARIVE
PËR HARTIMIN E S3, SI DHE KOORDINIMIN E PROCESIT
TË HARTIMIT DHE IMPLEMENTIMIT TË S3**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të neneve 5, pika 2, 11 e 12, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë,

URDHËR OJ:

1. Ngritjen e Komitetit Ndërministror në kuadër të përgatitjes së Strategjisë së Specializimit Inteligjent (*Smart Specialization Strategy*) (S3) dhe implementimit të saj, në vijim referuar si Komiteti, si dhe ngritjen e Ekipit Kombëtar të S3 për organizimin dhe ndjekjen e veprimtarive për hartimin e S3.
2. Komiteti të kryesohet nga Zëvendëskryeministri dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të ketë në përbërje këta anëtarë:
 - Ministrin e Financave dhe Ekonomisë;
 - Ministrin e Arsimit dhe Sportit;
 - Ministrin e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes;
 - Ministrin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
 - Ministrin e Turizmit dhe Mjedisit;
 - Ministrin e Kulturës;
 - Ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
 - Ministrin e Shtetit për Standartet e Shërbimeve;

- Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore për Programimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndihmës (SASPAC);
- Drejtorin e Përgjithshëm të INSTAT-it;
- Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA);
- Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI);
- Drejtorin e Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale;
- Drejtuesin e Ekipit Kombëtar të S3.

3. Në Komitet ftohen të jenë anëtarë:

- Kryetari i Konferencës së Rektorëve;
- Kryetari i Akademisë së Shkencave;
- Drejtuesi i Bashkimit të Dhomave të Tregtisë;
- Drejtuesi i Bashkimit të Prodhuesve Shqiptarë;
- Kryetari i Shoqatës për Autonominë Vendore.

4. Komiteti mund të zhvillojë mbledhje të hapura me të ftuar të tjera. Në mbledhjet e Komitetit, në varësi të çështjeve të rendit të ditës, mund të ftohen të marrin pjesë institucione të tjera, që nuk janë pjesë e Komitetit.

5. Komiteti ka për detyrë:

- a) të sigurojë mbarëvajtjen në kuadër të hartimit dhe implementimit të S3, si dhe të sigurojë drejtimin për zbatimin e raportimin e institucioneve, në kuadër të këtij procesi;
- b) të nxise bashkërendimin në nivel të lartë të institucioneve, me qëllim orientimin dhe udhëheqjen e punës, në përputhje me S3;
- c) të shqyrtojë draftin përfundimtar të S3, si dhe materiale të përgatitura në kuadër të këtij procesi, për të cilat kërkohet mendimi i Komitetit;
- ç) të rekomandojë masat e nevojshme ligjore, si dhe të orientojë punën organizative për nisma ligjore, në kuadër të S3;
- d) të ketë rol koordinues me nisma dhe iniciativa të tjera që lidhen me S3;
- dh) të nxise planifikimin për financimin e masave përmes programimit buxhetor afatmesëm, bashkëpunimit me partnerët e zhvillimit, përmes sistemit të planifikimit të integruar (SPI).

6. Komiteti mblidhet, si rregull, të paktën 2 (dy) herë në vit dhe sa herë që kërkohet nga Kryetari.

7. Komiteti të kryejë diskutime tematike për nxitjen dhe bashkërendimin e nismave konkrete, në mbështetje të hartimit dhe implementimit të S3.

8. Ekipi Kombëtar i S3 është struktura në nivel teknik, me këtë përbërje:

- | | |
|---|----------|
| - Znj. Linda Pustina, eksperte, këshilltare e Zëvendëskryeministrit, | kryetar; |
| - Znj. Florensa Haxhi, eksperte, Korporata e Investimeve, | anëtar; |
| - Z. Arben Shkodra, ekspert, Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë, | anëtar; |
| - Z. Geron Kamberi, ekspert, | anëtar; |
| - Znj. Elsa Dhuli, eksperte, INSTAT, | anëtar; |
| - Znj. Kozeta Sevrani, eksperte, Universiteti i Tiranës, | anëtar; |
| - Z. Genc Kojdheli, ekspert, Bashkia Tiranë, | anëtar; |
| - Z. Dhimitër Bako, ekspert, | anëtar; |
| - Znj. Elona Ajazi, Departamenti për Politikat dhe Mirëqeverisjen, në Kryeministri, | anëtar; |
| - Znj. Elira Demiraj, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, | anëtar; |
| - Znj. Zamira Gjini, Ministria e Arsimit dhe Sportit, | anëtar; |
| - Znj. Ana Petani, ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, | anëtar; |
| - Znj. Fiona Beqiri, AIDA, | anëtar; |
| - Znj. Mirela Muça, AKKSHI, | anëtar; |
| - Z. Aleksandër Xhuvani, Universiteti Politeknik i Tiranës, | anëtar. |

9. Ekipi Kombëtar i S3 t'i raportojë Zëvendëskryeministrit çdo tremujor në lidhje me ecurinë e procesit, si dhe të marrë miratimin e tij paraprak për dokumentet/produktet e përgatitura, sipas fazave të procesit të hartimit të strategjisë.

10. Ekipi Kombëtar i S3 ka për detyrë:

- të sigurojë hartimin e strategjisë nëpërmjet një procesi gjithëpërfshirës;
- të sigurojë mbështetjen e nevojshme për kryesuesin e Ekipit;
- të vlerësojë hartimin dhe/ose rishikimin e bazës ligjore, procedurave dhe udhëzuesve për hartimin e strategjisë;
- të japë kontribut direkt në procesin e hartimit të strategjisë për grumbullimin dhe analizën e të dhënavë, në përcaktimin e vizionit, të objektivave strategjikë e specifikë dhe për planin e veprimit, si dhe gjatë pranimit e miratimit të strategjisë nga Këshilli i Ministrave;
- të garantojë zbatimin e të gjithë komponentëve të përcaktuar në planin e aktiviteteve (*roadmap*), si dhe të përditësojë planin e aktiviteteve në bashkëpunim me JRC e KE;

- dh) të marrë pjesë, nëpërmjet përfaqësuesve të caktuar prej tij, dhe të raportojë në takimet në nivel kombëtar e ndërkombëtar, që lidhen me specializimin inteligjent, si dhe të paraqesë kontributet e progresin e Shqipërisë në këtë fushë, në kuadër të proceseve të integrimit të vendit në Bashkimin Evropian;
- e) të sigurojë koordinimin e procesit në komunikim me partnerët ndërkombe tarë dhe lokalë, JRC e KE, dhe përfaqësuesit e Delegacionit të BE-së në Tiranë;
- ë) të raportojë pranë kabinetit të Zëvendëskryeministrit çdo tremujor për securinë e punës.
11. Kryetari i Ekipit Kombëtar të S3 është përgjegjës për komunikimet me palët e treta, organizimin e punës dhe ndarjen e detyrave të Ekipit Kombëtar të S3, si dhe raportimin pranë Komitetit për securinë e punës së këtij Ekipi. Ai në konsultim me Ekipin Kombëtar të S3 mund të angazhojë ekspertë të huaj dhe vendas, të ngrejë grupe teknike pune për aspekte të caktuara të strategjisë, të aplikojë për financim të aktiviteteve në organizata kombëtare dhe ndërkombe tarë nëpërmjet instrumenteve të ndryshme, si dhe të bashkëpunojë me institucionet e tjera brenda dhe jashtë vendit, me qëllim bashkërendimin e punës dhe të aktiviteteve, në kuadër të përgatitjes së strategjisë.
12. Në mbledhjet e Ekipit Kombëtar të S3 ftohen të marrin pjesë ekspertë vendas dhe/ose të huaj, të shoqërisë civile, të organizatave kombëtare dhe/ose ndërkombe tarë, personalitete të fushës, si dhe përfaqësues të institucioneve të tjera shtetërore, sipas nevojave që lidhen me hartimin e S3, kur ato ftohen nga Kryetari.
13. Komiteti asistohet nga sekretariati teknik, rolin e të cilit e luan Agjencia Shtetërore për Programimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndihmës (SASPAC).
14. Sekretariati teknik ka për detyrë:

- a) të sigurojë miradministrimin e përgjithshëm të procesit, në përputhje me udhëzimet e Qendrës së Kërkimit të Përbashkët dhe të mbajë kontakte me përfaqësuesin e saj për Shqipërinë;
- b) të asistojë dhe të sigurojë mbështetje teknike për Komitetin dhe koordinimin e punës me institucionet e përfshira në proces;
- c) të sigurojë organizimin e mbledhjeve dhe paraqitjen e çështjeve për diskutim, të përgatitura në bashkëpunim me ministritë dhe aktorë të tjera pranë Komitetit;

- ç) të koordinojë procesin teknik me institucionet e ngarkuara për organizimin e takimeve, aktiviteteve dhe përgatitjen apo konsultimin e dokumenteve të ndryshme;
 - d) të sigurojë nxitjen e koordinimin e punës, përgatitjen e nismave të nevojshme ligjore, si dhe masave në lidhje me planifikimin për financimin në programin buxhetor afatmesëm;
 - dh) të kontribuojë në përgatitjen e dokumenteve të ndryshme që kërkoen, në kuadër të raportimeve, si dhe të përgatitjes së S3;
 - e) të kryejë çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga Komiteti dhe kryetari i tij, në përbushje të përgjegjësive të veta;
 - ë) të asistojë Ekipin Kombëtar S3, sipas udhëzimeve të kryetarit të Komitetit;
 - f) t'i raportojë drejtuesve të Komitetit dhe Ekipit Kombëtar të S3 në lidhje me ecurinë e punës.
15. Strategja e Specializimit Inteligjent (S3) të hartohej dhe të paraqitet për miratim në Këshillin e Ministrave, me propozimin e Zëvendëskryeministrit brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2024.
16. Kryetari i Ekipit Kombëtar të S3 mund të propozojë ndryshime në Ekipin Kombëtar të S3. Ndryshimet e anëtarëve të Ekipit Kombëtar të S3 dhe ndryshimi i sekretariatit teknik miratohen me urdhër të Zëvendëskryeministrit.
17. Mbështetja financiare për procesin e hartimit dhe implementimit të S3 sigurohet nga buxheti i shtetit, fonde të asistencës financiare të BE-së, partnerët për zhvillim dhe burime të tjera të ligjshme. Ngarkohet Zëvendëskryeministri për koordinimin e mbështetjes financiare në kuadër të këtij procesi.
18. Ngarkohen institucionet e drejtuara nga funksionarët e përmendur në pikën 2, të këtij urdhri, të përcaktojnë pikën e kontaktit në kuadër të procesit të S3, e cila do të jetë përgjegjëse për të gjitha komunikimet me Ekipin Kombëtar të S3 dhe sekretariatin teknik, si dhe për raportimet e institucionit që përfaqëson në kuadër të këtij procesi. Institucionet t'i komunikojnë sekretariatit teknik emrin e pikës së kontaktit brenda 5 (pesë) ditësh pune nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.
19. Ngarkohet kabineti i Zëvendëskryeministrit për ndjekjen dhe koordinimin e procesit të hartimit dhe implementimit të S3, si dhe të të gjitha aktiviteteve, iniciativave dhe masave që do të ndërmerren në këtë kuadër dhe koordinimin me çështjet që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me hartimin dhe implementimin e S3 në nivel kombëtar, ndërkombëtar apo rajonal, si

Green Growth, kapitali human (aftësitë dhe kualifikimet, profesionet e rregulluara, *brain circulation*, etj.), politikat industriale dhe inovacioni, politikëbërja e mbështetur në evidenca, si dhe çështje të tjera që do të identifikohen gjatë procesit të përgatitjes së S3.

20. Ngarkohet kryetari i Ekipit Kombëtar të S3 që, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, të sigurojë fillimin e punës së Ekipit Kombëtar të S3.
21. Urdhri nr.194, datë 18.11.2022, i Kryeministrat, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e Strategjisë së Specializimit Inteligjent (S3)”, dhe urdhri nr.121 datë 16. 3.2018, i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për ngritjen e grupit të punës për organizimin dhe ndjekjen e veprimtarive lidhur me hartimin e Strategjisë së Specializimit Inteligjent”, i ndryshuar, shfuqizohen.
22. Ngarkohen Zëvendëskryeministri, anëtarët e Komitetit Ndërministror dhe Ekipi Kombëtar i S3 për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

